

**KURS RRETH SUPERVIZIMIT TE SIGURUESVE BAZUAR NE  
PARALAJMËRIMIN E HERSHEM DHE AFTËSINË PAGUESE**

# **MODULI 2**

**HYRJE NE RISIGURIMIN  
JO-JETË**

Rodney Lester  
Serap Gonulal  
Banka Botërore

20 Nëntor 2006

## RISIGURIMI FAKULTATIV DHE ME MARRËVESHJE

1. Te gjitha kompanitë e sigurimeve përdorin risigurimin. **Risigurimi** ndodh atëherë kur një kompani sigurimesh kalon një pjese te riskut që ajo ka pranuar tek një kompani tjetër sigurimesh apo tek një kompani e specializuar risigurimi. Asnjë kompani nuk është aq e madhe sa të paguaje të gjitha kërkesat për siguracion kur bie një uragan, kur çahet tubacioni i naftës apo kur një avion rrezohet. Sa me të kufizuar të jeni kapitali dhe teprica e kompanisë, aq më e vogël është mundësia e saj për të përballuar një katastrofë. Kjo nënkupton që kompanitë e vogla kanë tendencë të jeni shumë me shumë të risiguruara se sa ato të mëdhatë.
2. Kontrata ndërmjet dy kompani sigurimesh njihet si një **marrëveshje risigurimi ose bashke-sigurimi**. Është quajtur marrëveshje dhe jo kontrate sepse kalon te koncepteve të një kontratave të biznesit ligjor. Marrëveshjet e risigurimit bazohen në zhvillimin e biznesit në mbi 300 vjet, prandaj edhe termat dhe mirëkuptimet janë të mbështetura mbi normat e industrisë dhe mirëkuptimet, gjëra të cilat nuk janë të përfshira domosdoshmerisht në një fjalor ligjor.
3. **Marrëveshja fakultative** është një organizim me anë të cilit një kompani jep risiguresit të gjithë informacionin për një policë dhe risiguresi vendos se në ç'kushte ai dëshiron ta pranojë riskun, nëse e pranon, rast pas rasti.
4. **Marrëveshja e risigurimit** është një organizim me anë të cilit risiguresi pranon riskun në mënyrë automatike nga regjistruesi i drejtpërdrejte.
5. Marrëveshja e risigurimit i nënshtrohet limiteve dhe praktikave të nënshkrimit si dhe kushteve të tilla si më poshtë vijon:
  - Siguresi i drejtpërdrejte pranon riskun deri në **nivelin e retencionit (ruajtjes)** të humbjes (i njohur si **prioriteti**). Kjo garanton që siguresi i drejtpërdrejte ka një interes në rezultatet e policës dhe e bën më të lehtë për risiguresin të pranojë pjesën e riskut. Niveli i drejtpërdrejte i retencionit të siguresit përfshin edhe çdo kërkesë siguracioni mbi **limitin** obligimeve të risiguresit.
  - Pasi risigurimi të jetë vendosur, siguresi i drejtpërdrejtë ruan pjesën e tij të riskut dhe nuk e risiguron atë diku tjetër, domethënë, ai vazhdon të ruajë interesin e tij mbi policën.
  - Risigurimi është tek policat i shkruar në të njëjtin formular me të njëjtat norma. Risqet përcaktohen mirë pastaj dhe të dy palët i kuptojnë ato. Nëse siguresi i drejtpërdrejte ndryshon produktet e tij, atëherë do të ketë nevojë për të bërë një marrëveshje të re ose për të amenduar marrëveshjen e tij ekzistues.

- Do të ndiqen një grup rregullash të nënshkrimit për të cilat të dy palët bien dakord.
  - Mund të ketë një kufi të masës së policës së sigurimit që do të jetë subjekt i marrëveshjes automatike. Çdo risk mbi atë masë do të sigurohet në bazë fakultative.
  - Biznesi, domethënë produkti, vjen nga një lloj i caktuar burimi të tilla si agjentët e drejtpërdrejtë të të sigurvearit. Biznesi që vjen nga përjasje të ndryshme të marketingut, për shembull, nga agjente, brokera të pavarur, marketing i drejtpërdrejtë, ka të ngjarë të ketë një eksperiencë të ndryshme.
  - Risqet kufizohen në një zonë të dhënë gjeografike.
6. Firmosja e një marrëveshje do të thotë se risigurveari ka besim tek sigurveari i drejtpërdrejtë. Ai ka ekzaminuar llojin e nënshkrimit që bën dhe bie dakord me vendimet e tij. Në fakt, risigurveari mund të ketë trajnuar nënshkruesit e sigurvearit të drejtpërdrejtë dhe, ndoshta, e pajis atë me një program kompjuteri që përgatit rregullat për nënshkrimin.
  7. Risigurveari do të audiojë kompaninë shkruese, domethënë regjistruese (ose **ceduese**) të drejtpërdrejtë në mënyrë sistematike. Nënshkruesit e risigurvearit do të ekzaminohen gjatë auditimit dosjet e tij për të parë nëse ai i ka zbatuar rregullat e nënshkrimit, apo jo. Një thyerje e rregullave nënkupton që risigurveari do ta anulojë marrëveshjen e shpejti.
  8. Shpesh do të ketë disa risigurvearë. Një risigurvearë është edhe **krye-risigurveari**. Ai është personi që do të monitorojë praktikën e sigurvearit cedues. Ai do të bëjë analizat me të detajuar të mundshme të riskut të sigurvearit. Tek risigurveari është e zakonshme të “ndiqet kreu” dhe pastaj kompanitë e tjera të firmosin bazuar në reputacionin e kreut vetëm.
  9. Risigurveari normalisht organizohet nëpërmjet brokerave të specializuar të risigurvearit. Pas skandaleve me të fundit, brokerat po bëhen më transparent lidhur me normat dhe termat e komisioneve të tyre – Shih Aneksin I.
  10. Në Aneksin II jepet një fjalor i termave të risigurvearit.

### **LLOJET E RISIGURIMIT JOJETËSOR**

11. Ka disa lloje risigurveari jo të jetës.
  - 11.1. Çdo kompani ka një limit lidhur me atë se sa pjesë të cilido risk mund të pranojë. Ky quhet **retencioni sipas riskut**. Një kompani risigurveari e drejtuar mirë do të **cedojë** riskun mbi këtë prioritet tek një kompani tjetër

e liçensuar sigurimi dhe risigurimi dhe, ne fakt, mund të detyrohet të luajë rolin e organit të rregullave të sigurimit ose të organit supervisor të sigurimit. Limiti i retencionit është një funksion i (a) oreksit të kompanisë për luhatje në fitime, (b) i masës së kapitalit dhe e tepicës së saj, (c) i asaj se çfarë bën konkurrenca e saj dhe (d) i caktimit aktual të risigurimit.

B
A

Tabela 1

A	B
---	---

Tabela 2

F		
C	D	E
A	B	

Tabela 3

*Tabelat tregojnë tre metoda të ndryshme për ndarjen e riskut të një police të ceduar nga A-ja ndërmjet kompanive risiguroese B,C,D,E,F. Lartësia e kuadrantit tregon shumën e humbjes së mundshme.*

**Eksesi i risigurimit të humbjes** siguron çdo gjë mbi retencionin. Kjo siguron mbrojtje kundër një kërkesë shumë të madhe për siguracion. Kjo ilustron në Figurën Nr. 1 me sipër ku kompania A i mban humbjet deri tek prioriteti dhe kompania B risiguron çdo gjë mbi këtë shumë deri në limitet e specifikuar në marrëveshjen e risigurimit.

**Risigurimi proporcional** e ndan kontratën ndërmjet dy ose me shumë kompanive dhe ato bashkëndajnë primet, shpenzimet, kërkesat për siguracion, etj. Kjo jo vetëm bashkëndon riskun, por ajo lejon ndihmë financiare për fitimin e një produkti të ri. Kjo ilustron në Figurën Nr. 2 ku kompanitë A dhe B bashkëndajnë të gjitha humbjet në të njëjtin raport. Bashkësigurimi aplikohet kur përfshihen dy siguroes të drejtpërdrejta dhe që mund të ketë edhe një policë të vetme të shkruar sebashku nga dy kompani ku secila merret drejtpërsëdrejti me të siguruarit.

Për risigurimin **jo-proporcional** (Shih Tabelën 1) përcaktimi i çmimit është futur tek primi i risigurimit. Për risigurimin proporcional (**pjesa e kuotave dhe linjat e tepicës**<sup>1</sup> – Tabela Nr. 2) vendosja e çmimit është tekstuale në **komisionit e këmbimit** që i është paguar siguroesit të drejtpërdrejtë për të mbuluar kostot e tij të përvetësimit dhe të administrimit.

<sup>1</sup> Linjat e tepicës është si bashkëndarja e kuotave – një organizim bashkëndarje proporcional i plote – por aplikohet vetëm ndaj risqeve mbi një masë të specifikuar.

11.2. Tabela e mbulimit te cilitdo risk mund te skicohet ne shume mënyra. Për shembull, ne Tabelën Nr. 3 ka një rregullim proporcional ndërmjet A-se dhe B-se plus tejkalimin e risigurimit te ndare ndërmjet C-se, D-se dhe E-se. Niveli me i larte mbahet nga një kompani tjetër qe është kompania F.

12. **Eksesi i risigurimit te humbjes ne rast katastrofe (Cat XOL)** ose "sigurim nga katastrofa" është risigurimi qe mbron kundër një ndodhie siç është uragani qe prek disa polica sigurimi njëkohësisht. Mund te ketë edhe sigurim te specializuar ndaj katastrofës siç është sigurimi nga tërmeti qe paguhet vetëm ne rastin e rënies se një tërmeti. Risigurimi ndaj katastrofës ndërhyt ne një nivel humbje te mbledhur ne totale dhe zakonisht është i organizuar ne shtresëzime mbi këtë nivel ku ka një **krye-sigurues** te ndryshëm për çdo shtresëzim. Risiguresit zakonisht nuk mbulojnë me shume se sa një numër te caktuar ndodhish dhe shpesh kërkojnë pagimin e një primi rehabilitimi për te vazhduar mbulimin mbas një ndodhie. Sigurimi i pjese se kuotës shpesh përdoret për te mbuluar rastet e katastrofave kur si është relativisht me pak i kushtueshëm ne krahasim me XOL (Eksesi i Risigurimit te Humbjes ne Rast Katastrofe).
13. Risigurimi i **Ndalimit te Humbjes** mbron një kompani nga një luhajtje e pazakonshme ne eksperience. Për shembull, ka raste kur ne disa vite ndodhin disa rrëzime avionësh. Risigurimi i ndalimit te humbjeve i ndalon humbjet e siguresit te drejtpërdrejtë ne një nivel te shprehur monetar ose ne një raport te caktuar humbje. Zakonisht retencioni i ndalimit te humbjes se risiguresit kufizohet edhe ne një shume te përcaktuar dhe ne një raport te eksedit ndaj prioritetit te siguresit te drejtpërdrejtë.
14. **Risigurimi financiar** organizohet për arsye financiare me shume se sa për arsye risku – për shembull, për te rregulluar një bilanc. Ai merr emrin e vet sepse risku është i mire-përkufizuar dhe i përcaktuar. Kompanitë e kuptojnë se risigurimi prek pasqyrat e tyre financiare kështu qe ato punojnë ne krah te kundërt me rezultatet qe duan te arrijnë ne kuadrin e një marrëveshje te përshtatshme. Kjo përfshin shume formulime financiare, gjë për te cilën eksperience ka treguar se jo gjithmonë është e ligjshme, veçanërisht, nëse transaksioni nuk është pasqyruar saktësisht ne llogarite e siguresit.
15. Kompanitë e sigurimit te përgjithshëm varen ne një mase te konsiderueshme tek risigurimi, pasi përvojat e tyre te humbjeve mund te luhaten me mënyre radikale nga njeri vit ne tjetrin ne vartësi te katastrofave natyrore, te motit, dhe te përqendrimeve te riskut. Kështu qe është shume e rëndësishme qe kompanitë e sigurimit te përgjithshëm te merren me risiguresit te cilët mund te paguajnë kur atyre u kërkohet te paguajnë. **Një nga arsyet kryesore qe kompanitë e sigurimit te përgjithshëm dështojnë është cilësia e dobët ose risigurimi i papërshtatshëm.**

## FONDI I BASHKUAR DHE RISIGURIMI NDËRKOMBËTAR

16. Sigurimi për risqe te veçanta shpesh organizohet nëpërmjet **fondeve te bashkuara**. Fondi i bashkuar është një mekanizëm i mbledhjes se riskut qe i ofron siguruesve/risiguruesve kryesorë një risk me te shumëllojshëm. Ne përgjithësi ka dy lloje fondesh te bashkuara. (1) Një kompani administron një fond te bashkuar për produkt, te cilin ajo e shkruan vete. (2) Një broker i një menaxheri profesionist administron një fond te bashkuar për biznes, i cili vjen nga disa burime.
17. *Fondi i Bashkuar i Administruar nga Kompania*: Ne këtë rast, një kompani shkruan shume polica sigurimi, te cilat kalojnë limitin e saj te retencionit. Kompania krijon një fond te bashkuar risigurimi ne vend qe t'i cedojë këto polica. Arsyeja kryesore është shpejtësia. Duke pasur një fond te bashkuar, kompania rrit limitin e retencionit, te cilin e kontrollon ajo, dhe ul, ne këtë mënyrë, numrin e policave te cilat duhet te cedohen për tek një risigurues. Ftohen edhe kompani te tjera qe t'i bashkohen fondit te bashkuar. Secila kompani qe i bashkohet këtij fondi pranon te marre një pjese te secilës police te ceduar tek fondi i bashkuar nga kompania qe e krijon atë. Çdo anëtar i fondit te bashkuar deklaron shumen maksimale qe është përgatitur te pranoje. Këto shuma maksimale individuale me pas mbledhen dhe ne këtë mënyrë formohet shuma totale e fondit te bashkuar. Proporcioni i çdo risku, te cilin e merr secili anëtar, është përqindja qe maksimumi i tij përbën ndaj totalit.
18. Për shembull, gjashte kompani i bashkohen një fondi te bashkuar dhe bien dakord te pranojnë shumat ne kolonën A te çdo risku. Pjesët e tyre te totalit tregohen ne kolonën B. Shumen e secilës policë qe do t'u caktohet atyre është gjithashtu edhe përqindja ne kolonën B.
- |               | A                 | B           |
|---------------|-------------------|-------------|
| Kompania A    | 2,200,000         | 22%         |
| Kompania B    | 150,000           | 1.5%        |
| Kompania C    | 3,500,000         | 35%         |
| Kompania D    | 1,450,000         | 14.5%       |
| Kompania E    | 550,000           | 5.5%        |
| Kompania F    | 2,150,000         | 21.5%       |
| <b>Totali</b> | <b>10,000,000</b> | <b>100%</b> |
- Nëse kompania qe drejton fondin e bashkuar ka një retencion prej 1 milion, tani ajo do te kontrolloje një retencion 11 milionësh nëpërmjet fondit te saj te bashkuar.
19. Çdo shume me e madhe se sa 10 milion do te vendoset nen një risigurues ndoshta ne baza fakultative.
20. Natyrisht qe për këtë fond te bashkuar ka rregulla. Kompania administruese duhet te mbaje retencion e plote te saj përpara se ajo te mund te vendose shumen e mbetur ne fondin e bashkuar.
21. Një kompani mund te administroje disa fonde te bashkuara. Ajo mund te ketë një për çdo linje produkti. Ajo, gjithashtu, mund te ketë nevojë për një fond te bashkuar te

ndare për çdo vend sepse jo të gjitha kompanitë që i bashkohen fondit të bashkuar janë në gjendje ose dëshirojnë të ndërmarrin risqe në çdo vend.

22. Një kompani mund të tërhiqet nga një fond i bashkuar, por ajo nuk mund të tërhiqet nga një risk sapo ajo ta ketë ndërmarrë atë. Prandaj, do të ketë fonde të reja të bashkuara që do të formohen çdo vit të cilat do t'u lejojnë kompanive mundësinë që të mos vazhdojnë asocimin e tyre me këto fonde dhe, në të njëjtën kohë, duke i lejuar mundësinë kompanive të reja t'i bashkohen fondit. Megjithatë një kompani është tërhequr nga shoqërimi me kompaninë organizuese, por pa u bashkuar me ndonjë nga fondet e saj të reja të bashkuara, ajo kompani do të vazhdojë të jetë përherë përgjegjëse për pjesën e saj të kërkesave në përputhje me policat e futura në fondin e bashkuar nuk ajo ishte anëtare.
23. *Fondi i Bashkuar i Administruar nga Pale e Trete:* në llojin e dytë të fondit të bashkuar kompanitë mund të dëshirojnë të sigurojnë një lloj të pazakonte apo të ri risku, por ato kanë frikë se nuk do të biznes të mjaftueshëm të atij lloji për të përfituar nga ligji i shifrave të mëdha. Shumë kompani bien dakord të bashkëndajnë të gjithë risqet e tyre të këtij lloji. Kjo do të sigurojë një shabllon të një përmase të mjaftueshme për të dhënë rezultate të parashikueshme dhe konsekuente nga viti në vit. Kjo ishte, në fakt, mënyra se si filloi sigurimi i aeroplanëve moderne për pasagjere.
24. Bashkëndarja e secilës police mund të jetë sipas asaj se sa produkt fut secila kompani në fondin e bashkuar ose mund të ketë një formulë lidhur me masën e riskut që do të pranonte çdo kompani në një rast të ngjashëm me shembullin e fondit të bashkuar (1).

#### **SIGURIMI I RISQEVË TË MËDHA INDUSTRIALE DHE SHUMËKOMBËSHE**

25. Korporatat e mëdha shumëkombëshe kanë nevojë për shuma të mëdha sigurimi për mbulimin e rafinerive, uzinave të shkrirjes së metaleve, detyrimeve të mundshme, etj. Asnjë kompani sigurimesh nuk mund të ofrojë një sigurim të tillë e vetme, prandaj nevojiten risiguruesit. Kompania që blen siguracionin ka një interes të madh për atë se kush janë risiguruesit. Nëse risiguruesit nuk janë të fuqishëm, ata nuk do të paguajnë dot kërkesat nëse u kërkohet një gjë e tillë dhe, për rrjedhojë, kompania e madhe multinacionale nuk do të marrë pagesën e siguracionit.
26. Termat e marrëveshjeve të risigurimit janë me interes të madh, gjithashtu, për të siguruarit dhe kjo përcakton nëse risiguruesi duhet të paguajë apo jo në rast të një humbje serioze.
27. Një korporatë shumëkombëshe mbare botërore nuk mund të varet nga siguruesit primare në çdo vend që këta të fundit të bëjnë negociimin e risigurimit në kompanitë me të fuqishme dhe që ata të formulojnë siç duhet marrëveshjet e risigurimit me secilën prej tyre. Prandaj, një korporatë shumëkombëshe do ta organizojë vetë risigurimin duke përfshirë formulimin e kontratës dhe duke zgjedhur vetëm

risiguruesit me te fuqishëm. Ndoshta kontrata e risigurimit mund te ketë një **klauzole direkte**<sup>2</sup>.

28. Ky përbën një organizim i veçante sepse risigurimi behet përpara se zgjidhet kompania primare e sigurimit. Korporata shumëkombëshe do te zgjedhe pastaj një kompani ne një treg vendas për te shkruar sigurimin ne atë kompani dhe për ta kaluar atë tek risiguruesit qe janë përcaktuar tashme (te njohur si **fronting** -shih me poshtë). Cilado kompani qe zgjidhet do te lejohet te mbaje aq risk sa korporata shumëkombëshe e beson se kjo e fundit mund ta paguaje ne rast kërkesë. Kjo mund te jete zero.
29. Korporata shumëkombëshe edhe mund te vendose te përdorë si sigurues primare kompaninë e saj vartëse te sigurimit qe është e vendosur ne vende te huaja.
30. Fronting përdoret edhe nga kompanitë qe nuk janë te licencuara te regjistrojnë apo te shkruajnë ne një territor. Ato gjejnë dike tjetër qe është i licencuar dhe mund te lëshojë polica duke shmangur ne këtë mënyrë problemin e licencimit.
31. Sipas këtij organizimi, i siguruari nuk ka kontrate me kompaninë e palicensuar dhe sigurohet nga kompania qe e ka pajisur me police. Kështu, risku është për kompaninë e licencuar dhe jo për te siguarin.
32. Ne disa raste te kompanive qe ndodhen ne vende te huaja kjo është shume e përshtatshme por nuk ka produkt te mjaftueshëm qe te dëshirojnë te hyjnë ne vend. Për mbulim specialiteti, ky mund te jete burimi i vetëm.

#### **FONDET RAJONALE TE BASHKUARA DHE KOMPANITË E RISIGURIMIT**

33. Shume vende kane fonde te bashkuara risigurimi. Për shembull, Pakistan, Iran dhe Turqia kane pasur Organizatën e Bashkëpunimit Ekonomik qe ne vitin 1966, e cila është një seri fondesh te bashkuara risigurimi qe përdoren nga kompanitë e risigurimit shtetëror. Ka fonde te bashkuara për zjarret, marinën, aksidentet, inxhinieritë dhe aviacionin. Kompani te ndryshme kombëtare administrojnë secilin fond te bashkuar.
34. Kompania Afrikane e Risigurimit risiguron risqet e kompanive ne Afrike. Ka edhe një Kompani Aziatike te Risigurimit qe operon jashtë Bangkokut. Këto kompani janë kryesisht fonde te bashkuara risigurimi te cilat ndihmojnë kompanitë rajonale qe ato te kenë një objektiv për t'i mbajtur primet ne rajon.

---

<sup>2</sup> Klauzola direkte shprehet se kompania e risigurimit do t'i paguaje kërkesat drejtpërsëdrejti te siguarit nëse kompania primare humbet aftësinë paguese. Ne këtë mënyrë, i siguruari është i sigurt se do te paguhet. Pa një klauzole te tille direkte risiguruesi do te agjente likuidatorin e një kompania pa aftësi paguese dhe paratë do te ndaheshin ndërmjet te gjithë te siguarve dhe kreditorëve te kompanisë se falimentuar.



35. Risiguruesit, te cilët kane baze rajonale dhe shteti, shpesh nuk janë risigurues te vërtetë. Roli i tyre është te mbledhë riskun, ta kaloje atë e te japë mbështetje teknike për siguruesit e drejtpërdrejte lokale.

#### **SIGURIMI JASHTË VENDIT**

36. Kompanitë e risigurimit jashtë vendit janë kompani qe operojnë ne zona te veçanta te cilat shpeshherë i nënshtrohen një ambienti me pak kërkues përse i përket rregullave dhe taksave. Një pjese e madhe risigurimi kryhet nëpërmjet këtyre qendrave megjithëse një pjese e konsiderueshme e menaxhimit faktik te këtyre kompanive kryhet nga ne zyrat baze ne Evrope, Londër dhe Nju Jork. Disa qendra jashtë vendit janë përdorur për te lëvizur kapital dhe fitime dhe, ndoshta, edhe për pastrim parash. Autoritetet, ne një numër vendesh, po fillojnë te kufizojnë spektrin e përdorimit te objekteve te tilla nga siguruesit e drejtpërdrejte.

#### **DEGËT E ZOTËRUARA NGA AGJENTËT**

37. Kompanitë duan qe agjentet e tyre te sigurojnë produkt te mire. Agjentet duan te paguhen për punën qe bëjnë. Edhe kompanitë dëshirojnë te mbajnë agjentet tyre te mire. Për te gjithë këto arsye u shpiken degët e zotëruara nga agjentet.
38. Një dege e zotëruar nga agjentet është një kompani sigurimi tek e cila drejtori cedon një pjese te biznesit te shkruar nga një agjent i veçante.
39. Ne këtë mënyrë, agjenti merr pjese ne fitimet qe rrjedhin nga biznesi qe ai ka shkruar.
40. Kompania mund te zotërohet nga një agjent i vetëm ose nga një grup agjentesh. Nëse ajo zotërohet nga një grup agjentesh, ata do te marrin pjese ne fitim nëpërmjet llogaritjes se ndare te fondit qe korrespondon me klasat e aksioneve (p.sh., klasa 1, klasa 2 ...) me disidentet e deklaruar mbi çdo fond, ose agjentet mund te merrnin pjese ne fitimin e grumbulluar sebashku.
41. Degët mund te "lëshohen me qira" për ta vendosur këtë produkt. Kompania administrohet nga një pale e trete e cila lëshon çeqet e dividendit për agjentet ne fund te vitit.

#### **ÇËSHTJE RREGULLATORE DHE TE MBIQYRJES**

42. Autoritetet ne shume vende po shqetësohen rreth cilësisë se risigurimit te blere nga siguruesit vendas. Kjo reflekton shume dështime pas katastrofave natyrore ose pas kërkesave te mëdha për dëmshpërblim ku risigurimi ka treguar se ka qene i pamjaftueshëm dhe jofunksional. Shembuj te tillë përfshijnë Brazilin dhe Meksikën si dhe shume vende te tjera industriale dhe ne tranzicion ku kërkohet njëherazi siguria minimale e risigurimit, ose kur risigurimi kërkohet te lejohet si kundërbalancim për qëllime te aftësisë paguese.
43. Risigurimi mund edhe te keqpërdoret për fshehjen e fitimeve, për lëvizjen e kapitalit dhe për te organizuar pastrimin parave – kjo është tani ne rendin e ditës se FATF.

44. Virtualisht, çdo mbikëqyrës sigurimi ne bote ka te drejte te monitoroje organizimet e risigurimit për siguresit vendas dhe te kërkojë qe ato te forcohen.
45. Disa vende industriale kërkojnë edhe qe siguresit e drejtpërdrejte te kenë rregulla qe specifikojnë maksimumin sipas retencionit te riskut dhe te ndodhive dhe, mundësisht, primin minimal te mbledhur qe është ruajtur. Kjo kërkesë e dyte siguron qe operojnë vetëm sigures reale, dhe jo agjente te maskuar si sigures.

### **ÇËSHTJE TE KONTABILITETIT DHE TE KONTROLIT**

46. Kontabiliteti i risigurimit është shume kompleks dhe nuk mund te mbulohet plotësisht ne kuadrin e këtij kursi te shkurtër. Megjithatë, është e rëndësishme qe organi i menaxhimit kupton ndikimin kapital dhe përfitues te strategjive te ndryshme te risigurimit.
47. Për shembull, risigurimi, përveç faktit qe është një kosto e te berit biznes (zakonisht rreth 8% e koston neto te GWT-se gjate kohës për një sigures te madhësisë se nivelit te mesëm) ai është edhe një mundësi për te ndërtuar financiarisht strukturën financiare te siguresit dhe për te kërkuar mundësi arbitrazhi ndërmjet tregjeve dhe ndermet llojeve te ndryshme te risigurimit. Menaxheri i risigurimit mundet, ne disa vite, te beje ose te ndërpresë pasqyrën e fitimeve dhe humbjeve.
48. Për arsye te rëndësisë se risigurimit – veçanërisht për siguresit jojetësorë, struktura drejtuese e siguresit duhet te garantoje qe bordet tregojnë një interes e veçante ne këtë teme dhe sistemet e kontrollit te brendshëm duhet te garantojnë qe risiguresi do te paguaje ne momentin kur lind nevoja.


### **ROLI I RISIGURUESVE NE KRIJIMIN E TREGJEVE**

49. Risiguresit shpesh japin asistence thelbësore për kompanitë e vogla ne krijimin e tregjeve. Ato trajtojnë stafin dhe ofrojnë norma, polica dhe procedura.
50. Risiguresit, gjithashtu, imponojnë disipline mbi këto kompani te reja veçanërisht ne tregjet qe krijohen. Janë risiguresit ata qe u tregojnë atyre se çfarë rezervash te mbajnë dhe çfarë primesh te vendosin. Ne vendet ku ka pak, ose kur nuk ka fare rregulla, ky është një rol ekstremisht i rëndësishëm qe luhet nga risiguresi.
51. Kompanitë e risigurimit tani nënkontraktojnë shume funksione siç është dezinjimi i produkteve, strategjia e investimit me te gjithë formulat e saj aktuale, vete investimet, punën aktuale, nënshkrimin, e kështu me radhe. Prandaj risigurimi është një metode për te pasur një partner teknik, ku ky i fundit nuk zotëron aktualisht ndonjë aksion te kompanisë. Sigurimi mund te jete e vetmja industri qe e ofron këtë përqsje. Risiguresi jo vetëm ofron transferimin e teknologjisë, por sheh edhe pasuritë e tij qe rriten ose qe ulen ne raport me përvojën e kompanisë.

## Te Kuptuarit e Një Marrëveshje Risigurimi

### FORMAT MARRËVESHJE

52. Marrëveshja e risigurimit, ne terma shume te përgjithshme, përcakton pagesat ndërmjet kompanive te risigurimit. Ne forme grafike ai ka paraqitjen e mëposhtme:



53. Sipas kësaj diagrame Kompania 1 cedon biznesin tek Kompania 2. Marrëveshja i kërkon Kompanisë 1 te beje pagesa ose te transferoje fonde tek Kompania 2. Këto pagesa zakonisht quhen pak a shume si (1) prime fillestare ose depozite, (2) prime vjetore (3) te ardhura investimi, dhe (4) çmim risku. Jo te gjitha marrëveshjet do t'i përmbajnë te gjitha këto zëra, ashtu siç do te ketë marrëveshje qe mund te përmbajnë me shume.

54. Kompania 2 gjithashtu duhet te beje pagesa ose transferim fondesh tek Kompania 1. Këto pagesa do te quhen pa a shume si (1) kompensimi i komisionit te kumbimit, (2) kompensimi i shpenzimeve (3) kërkesat për dëmshpërblim dhe (4) rritja e rezervave. Përsëri, jo te gjithë marrëveshjet do t'i përmbajnë te gjitha këto zëra, ashtu siç do te ketë marrëveshje qe mund te përmbajnë me shume.

55. Nëse shohim te gjithë transfertat e bëra për tek Kompania 2 dhe te zbresim atë qe duhet kthyer, atëherë duhet te ketë një fitim. Marrëveshje mund te ketë një klauzole për ta bashkëndarë këtë fitim me Kompaninë 1 dhe kjo pjese e fitimit kthehet me

emërtime te tilla si komision fitimi, rifinancim i vlerësimit te eksperiencës, ose çmim fitimi apo bashkëndarje fitimi.

56. Fleksibiliteti ne risigurim qëndron ne atë se secila prej këtyre termave mund te përcaktohet ne mënyra te ndryshme.
57. Ne shumicën e rasteve pagesat ndërmjet kompanive mblidhen ne mënyrë qe te behet vetëm një transferim fondesh. Kjo është quajtur e drejta e kundërbalancimit. Çdo kompani ka te drejte te kundërbalancojë atë çfarë ajo disponon dhe are çfarë disponohet.
58. Për te kuptuar marrëveshjen e risigurimit, është e dobishme te mbahet parasysh se i gjithë risigurimi ka tre grupe shifrash dhe termash:

Njeri grup fillon marrëveshjen,

I dyti përcakton se si vazhdon marrëveshja (çfarë ndodh çdo vit) dhe

I treti përcakton se çfarë ndodh kur marrëveshja përfundon.

59. Ne marrëveshjet e kufizuara ose financiare te risigurimit te hyrat e hapjes janë shpeshherë me te rëndësishmet meqenëse janë te gjera dhe ndikimi i tyre është ai qe, ne njëfarë mënyre, ndryshon bilancin apo llogarite për te arritur objektivat e marrëveshjes. Ne risigurimin e rregullt, te hyrat e hapjes mund te jene te vogla dhe ato mund te jene te njëjta me te hyrat vjetore.

60. Disa pika për t'i studiuar:

Çfarë është risiguruesi? A është ajo një kompanie fuqishme me reputacion?

Cili është përkufizimi i biznesit, domethënë i produktit, te risiguar? Blloku i produkteve duhet te identifikohet ne një mënyrë te qarte duke dhënë datën e lëshimit, formularin e policës se sigurimit te përdorur për produktin, llojin e produktit dhe çdo informacion qe nevojitet per te identifikuar primet, rezervat, etj.

A duhet te mbahen korrekt rezervat nga secila pale ne mënyrë nga pikëpamja aktuariale, domethënë, e ekspertizës se sigurimeve?

Sipas cilave kushte duhet te paguaje risiguruesi?

Cili është risku i risiguar aktualisht? A është ai i gjithë risku qe kompania shkruese e drejtpërdrejte ka presupozuar? Nëse nuk është, atëherë a janë llogaritur rezervat respektivisht?

A ka likuiditet ne marrëveshje? A do te duhet qe risiguruesi te paguaje kesh menjëherë sapo paraqitet kërkesa për dëmshpërblim apo do te jete ne gjendje ta vonoje pagesën?

A do te mundet risiguruesi te shpëtoje pa paguar apo pa kryer funksionet për te cilat ai është angazhuar te kryeje? Ne cilat kushte mundet risiguruesi te anulohet kontratën? Ne rastin e anulimit, cilat janë përgjegjësitë e mbetura për risiguruesin?

Sa kohe zgjat marrëveshja? A është marrëveshje pa afat apo me një afat kohor te përcaktuar? A do te ndërpresë risiguruesi pranimin e Risqeve te reja ne një kohe te caktuar? A e ndërpret sigurimin e Risqeve qe kishte pranuar tashme ne atë kohe?

Kush ka përgjegjësi për kohen ne çdo biznes/produkt?

A është risiguruesi një sigures i njohur? Nëse risiguruesi nuk është i njohur, atëherë nuk mund t'i jepet besimi i rezervës ne qofte se nuk do te bëhen veprimet qe garantojnë se paratë janë te disponueshme. Veprime apo organizime te tilla përfshijnë letër besimi, fond besimi, ose mos-transferim asetesh. A janë bere tashme rregullime te tilla?

A ka një klauzole arbitrazhi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve?

#### **DISA TERMA STANDARDE TE MARRËVESHJES SE RISIGURIMIT**

61. Palët ne marrëveshje cedojnë kompaninë dhe risiguruesin. I siguruari nuk përfshihet dhe kështu qe normalisht nuk ka kërkesë dëmshpërblimi ndaj risiguruesit. Ne shumicën e rasteve mbajtësi i polices, domethënë i siguruari, nuk do ta dije se polica është risiguar.
62. Risigurimi zakonisht është një organizim dëmshpërblimi. Risiguruesi dëmshpërblen kompaninë ceduese për atë qe ajo paguan për kërkesat.
63. Te dy palët kane te drejte te mbrohen kundër një kërkesë, dhe nëse njëra pale vendos te mos veproje ne këtë mënyre, atëherë ajo do t'i paguaje pjesën e saj kompanisë tjetër dhe e le atë te absorboje te gjitha kostot ligjore. Nëse mbrojtja është e suksesshme, pala qe nuk i është bashkuar mbrojtjes nuk përfiton rimbursim.
64. Risiguruesi ka te drejte te inspektojë ne çdo kohe rekordet e kompanisë ceduese.
65. Do te shprehet edhe përcaktimi i ligjit qe zbatohet. Ne rast te një mosmarrëveshje ndërmjet palëve nuk do te humbet kohe duke argumentuar se cili ligj aplikohet. Klauzola do te shprehë se zbatohet ligji për... Kjo përdoret rralle. Zgjedhja ka gjase te jete ligji i juridiksionit te njëres prej palëve. Nuk ka te ngjare qe ndonjëra nga palët te ketë ndonjë ide lidhur me ndryshimet ndërmjet ligjeve qe mund te zbatoheshin për mosmarrëveshjet e risigurimit ne juridiksione te ndryshme.
66. Klauzola e gabimeve dhe e mangësive shprehet se gabimet e paqëllimta do te rregullohen ne pasqyrën pasardhëse dhe se nuk përbejnë shkak për te anuluar kontratën.
67. Një klauzole "ekuivalente ne mënyrë aktuale" mund te kurseje faqe te tera formulash për atë qe ndodh nëse marrëveshja përfundon ne kohe te ndryshme. Marrëveshja

mund te shprehet se çfarë ndodh nëse afati i përfundimit është data 31 Dhjetor dhe nëse ajo përfundon ne periudha te tjera kohore, atëherë do te behet axhustimi ekuivalent ne mënyrë aktuale.

### **Marrëveshjet për Taksat**

68. Risigurimi qe është transferuar jashtë vendit shpesh i nënshtrohet taksues se akcizës, zakonisht nga 1% deri ne 3% te primeve te risigurimit.
69. Marrëveshjet për taksat ndërmjet vendeve shpesh trajtojnë çështje te taksës se akcizës dhe, ne disa raste, bëhen përjashtime nga kjo takse. Për shembull, nuk ka takse akcize te Shteteve te Bashkuara te Amerikës mbi marrëveshjet e risigurimit me Britaninë e Madhe.
70. Rruga qe ndjek risigurimi varet shume nga marrëveshjet për taksat ndërmjet kombeve. Prandaj risiguresit do te kenë njohuri te mira te këtyre marrëveshjeve meqenëse taksa, le te themi 2%/, mbi primet është domethënëse.
71. Një mënyrë tjetër për te ulur këtë barre takse është formulimi i marrëveshjeve ne mënyrë te tille qe ndërmjet kompanive te kaloje kalon fare pak prim.
72. Një tjetër konsiderate është mbajtja e taksës mbi dividendët qe paguhen nga kompanitë e sigurimit për kompanitë e tyre qendrore. Mungesa e një mbajtje te tille takse ose përjashtimi brenda një marrëveshje influencon edhe aktivitetin e risigurimit.

## ANEKS I DEKLARATE E TRANSPARENCËS SE BROKER-IT TE RISIGURIMIT

### **Guy Carpenter konfirmon Përkushtimin Ndaj Transparencës se Plote Nju Jork, 16 Dhjetor 2004**

Guy Carpenter & Company, Inc., specialit udhëheqës ne fushën e riskut global dhe risigurimit dhe pjese e Marsh & McLennan Companies (NYSE: MMC), deklararon sot se ka botuar një “Doktrine te Transparencës” për rregullimin e marrëveshje ne mënyrë globale. Politika e re, e cila është e përfshirë ne tekstin e mëposhtëm te kësaj komunikate, u ekspozua përpara klientëve te Guy Carpenter dhe tregjeve te risigurimit ne fillim te këtij muaji.

Ne një letër drejtuar klientëve, e cila mban datën 01 Dhjetor 2004, e cila shpall politiken e re, Salvatore D. Zaffino, Kryetar i Guy Carpenter’s & CEO, u shpreh se “ka një nevojë brenda industrisë për te trajtuar çështje te transparencës se plote ndaj klientëve brenda tregut te risigurimit”. “Raporti i Guy Carpenter me klientët e tij është ndërtuar ne baze te besimit qëndrueshëm për kohe te gjate dhe mbi aftësinë tone për te ndihmuar klientët tanë qe te marrin vendime me te rëndësishme ne ambient te vështirë. Transparenca dhe hapja ndaj publikut duhet te forcojnë besimin ndërmjet palëve te kontratës se risigurimit dhe te formojnë një vendim marrje me te mire. Qe nga momenti kur ne shpallëm përkushtimin tone ndaj transparencës, kontributi nga klientët dhe tregjet e risigurimit ne mbare boten ka qene jashtëzakonisht pozitive” tha Zaffino.

“Industria përballet me shume sfida tani duke filluar nga degradimi normave dhe i sigurisë financiare deri tek performanca e pagesës se kërkesave dhe standardet e praktikës ne te gjithë boten. Guy Carpenter synon te jete një force pozitive ne trajtimin e këtyre dhe te tjera çështjeve ne mënyrë individuale me klientët tanë dhe si agjenti ndryshimit ne te gjithë industrinë” konkludoi Zaffino.

“Doktrina e Transparencës ” e Guy Carpenter trajton format e larmishme te kompensimit te firmës, duke përfshirë normat standarde te brokerimit për rregullimin e marrëveshjeve, tarifën për shërbimet dhe historinë e firmës ne marrëveshjet e tregut, te cilat kane skaduar ose janë përfunduar te gjitha.

Si pjese te “Doktrina e Transparencës ” se tij, është zotuar te beje ne mënyrë te përhershme transparencën e mëposhtme:

- Kur një klient emëron Guy Carpenter si broker te rekordit, ne do te paraqesim përpara klientëve tanë kompensimin qe ne parashikojmë te marrim për shërbimet qe do te ofrohen ne emër te klientit.
- Përpara rinovimeve pasuese te kontratave te risigurimit, ne do te rishikojmë bashke me klientin tone kompensimin e pritshëm te Guy Carpenter bazuar ne normat standarde te komisionit. .
- Guy Carpenter do te vazhdoje te përpiqet për përputhshmëri ne funksion te normave te brokerimit qe do te fitohen nga Guy Carpenter brenda një shtresëzimi dhe do te shpalle çdo ndryshim te normave përpara te gjithë palëve qe i përkasin atij shtresëzimi.

- Brokerimi për çdo transaksion risigurimi do të radhitet në Shënimi Shoqërues për të gjithë produktin e marrëveshjes.

Politika e mësipërme mbulon rregullimin e marrëveshjeve në mënyrë globale, gjë e cila përbën mbi 90 përqind të të ardhurave të Guy Carpenter dhe do të shtrihet për të përfshirë rregullimet fakultative sapo të përfundohet një rishikim mbare botëror i praktikave të tanishme.

Guy Carpenter & Company, Inc., është specialist udhëheqës në fushën e riskut global dhe risigurimit dhe pjesë e Marsh & McLennan Companies Inc. Guy Carpenter krijon dhe ekzekuton zgjidhje të risigurimit dhe të menaxhimit të riskut për klientë në mbare botën nëpërmjet me shumë se 2,400 profesionistëve në të gjithë globin. Diapazoni i plote i shërbimeve përfshin 16 qendra të përsosmërisë në fushën e Aksidenteve & Shëndetit, Agrikulturës, Transferimit të Riskut Alternativ, Ambient, Viktimat në Përgjithësi, Veprime Bankare të Investimeve, Jeta & Pensioni Vjetor, Marina dhe Energjia, Detyrimi Profesional, Zgjidhje për Menaxheret e Programeve, Pronësia, Cedimi i Një Pjesë apo i të Gjithë Riskut të Risiguruar, Risk i Strukturuar, Garancia, Risku i Terrorit dhe Kompensimi Punëtorëve. Gjithashtu, njësi Instrat® e Guy Carpenter përdor aftësi dhe pajisje modelimi sasiore që janë udhëheqëse në industri dhe që optimizojnë procesin e vendim marrjes për risigurimin dhe i ndihmon klientët e firmës të bëhen me të suksesshëm. Guy Carpenter ka faqen e tij të internetit si vijon: [www.guycarp.com](http://www.guycarp.com).

### ***Rregullimi i Marrëveshjeve***

Në dritën e zhvillimeve të fundit që prekin industrinë, Guy Carpenter beson se është e rëndësishme të trajtohet çështja e kompensimit në fushën e vendit të tregut të brokerit të risigurimit dhe të përfitohet nga kjo mundësi për të riafirmuar përkushtimin ndaj klientëve tanë në këtë aspekt. Prandaj, Guy Carpenter krijoi këtë **Doktrinë të Transparencës**, e cila identifikon procedurat tona lidhur me shërbimet që ne ofrojmë, etiken që ne përkrahim, dhe mënyrën e përgjithshme me të cilën kompensohet Guy Carpenter.

### **Kompensimi dhe Shërbimet**

Me poshtë skicohet mënyra me të cilën Guy Carpenter merr pagesën për shërbimet e rregullimit të marrëveshjeve që ai ka dhënë si ndërmjetësues risigurimi:

#### ***Komisione e Brokerit (Brokerimi)***

Praktika e qëndrueshme e Guy Carpenter është të përputhë normat e brokerimit me ligjet dhe përdorimin e industrisë. Gjithashtu në vazhdojmë të mbështesim konsekuencën e normave brenda një rregullimi dhe shpallje të normave të brokerimit. Për këtë qëllim, Guy Carpenter përcakton me poshtë normat e brokerimit që do të aplikoheshin ndaj shumicës së produktit që ne rregullojmë. Këto norma janë udhëzime dhe janë përgjithësisht standarde në treg, por që mund të ndryshojnë në vartësi të specifikave të një rregullimi të veçantë.



- **Guy Carpenter përgjithësisht merr brokerim ne proporcion me rregullimet ndërmjet 1% dhe 2.5% te primit bruto. KA edhe disa rregullime ku brokerimi është me i madh se 2.5%.**
- **Për eksese te rregullimeve te humbjes, Guy Carpenter përgjithësisht merr një brokerim prej 10% te primit te kontratës.**
- **Kur eksesi i rregullimeve te humbjes behet ne tregun e Londrës, vendoset një brokerim shtese prej 5% dhe ruhet nga brokeri partner i Londrës. Shpesh përdoret për këto rregullime një broker Londinez i lidhur me Guy Carpenter.**
- **Ne disa tregje, Guy Carpenter merr një brokerim deri ne 5% mbi primet e ristrukturuar.**
- **Ne rastin e disa rregullimeve risiguruesit i paguhet një marzh i shprehur. Ne këto raste, Guy Carpenter zakonisht merr 20% te marzhit.**

### ***Tarifat e Shërbimit***

Përveç rolit tone tradicional te ndërmjetësit te risigurimit, Guy Carpenter ofron edhe shërbime te tjera “jo-tradicionale” te lidhur me risigurimin për te cilat ne përfitojmë tarifa. Te ardhurat nga këto aktivitete përfaqësojnë një raport te vogël te ardhurave vjetore te Guy Carpenter. Aktualisht dy shembujt kryesore te këtyre shërbimeve janë si me poshtë vijon:

- **Reinsurance Solutions International, LLC është një kompani vartëse e Guy Carpenter qe merr tarifa për ofrimin e shërbimeve te grupuara si administrim policash, administrim kërkesash, mbledhje te primeve/risigurimit, kontabilitet ligjor/GAAP, zbatueshmëri rregullatore dhe auditim. Gjithashtu, RSI –ja ofron shërbime te specializuara konsulence duke u fokusuar ne riformulim procesi, krahasim, dhe metrikë e matje te menaxhimit te performancës.**
- **Guy Carpenter & Company, Inc., e Pensilvanisë është një kompani vartëse e Guy Carpenter dhe është një menaxher i licensuar risigurimi qe mbikëqyr objektin e dorëzarisë se risigurimit për risigurues te caktuar. Ky objekt nënshkrimi pranon produkte nga kompani me te vogla rajonale dhe te ndersjellta.**

### ***Historia e Marrëveshjeve te Tregut***

Ne te kaluarën, Guy Carpenter hyri ne një numër te kufizuar marrëveshjesh me disa risigurues te caktuar qe i ofronin pagese Guy Carpenter. Këto marrëveshje, ne total dhe ne një vit, përfaqësonin një përqindje shume te vogël te të ardhurave ne total te Guy Carpenter. Te gjitha marrëveshjet e tilla ose kane skaduar ose janë përfunduar.

### ***Transparenca***

Guy Carpenter beson se vendi i tregut te risigurimit do te përfitonte nga një transparence me e madhe me klientë lidhur me kompensimin e brokerave. Ne mënyrë qe te nxitet ky

objektiv, Guy Carpenter do et zbatoje hapat e mëposhtëm qe hyjnë ne fuqi me 1 Janar 2005:

- Kur një klient emëron Guy Carpenter si broker te rekordit, ne do te paraqesim përpara klientëve tanë kompensimin qe ne parashikojmë te marrim për shërbimet qe do te ofrohen ne emër te klientit.
- Përpara rinovimeve pasuese te kontratave te risigurimit, ne do te rishikojmë bashke me klientin tone kompensimin e pritshme te Guy Carpenter bazuar ne normat standarde te komisionit. .
- Guy Carpenter do te vazhdoje te përpiqet për përputhshmëri ne funksion te normave te brokerimit qe do te fitohen nga Guy Carpenter brenda një shtresëzimi dhe do te shpalle çdo ndryshim te normave përpara te gjithë palëve qe i përkasin atij shtresëzimi.
- Brokerimi për çdo transaksion risigurimi do te radhitet ne Shënimi Shoqërues për te gjithë produktin e marrëveshjes.

## ANEKSI II – FJALOR I TERMAVE

**Risigurimi i Njohur** – Një kompani “njihet” kur ajo është liçensuar dhe njohur nga autoritetet e duhura qeveritare të sigurimit të një shteti apo vendi. Për të përcaktuar gjendjen e saj financiare një siguruesi cedues i lejohet të marrë besimin për primet e pafituara dhe për kërkesat e papaguara mbi risqet e risiguruara nëse risigurimi është bërë në një kompani të njohur risigurimi.

**Klauzola e Arbitrazhit** - Gjuha që siguron një mjet për zgjidhjen e diferencave ndërmjet risiguruesit dhe të risiguruarit pa proces gjyqësor. Zakonisht, çdo palë cakton një arbitruer. Dy të emëruarit zgjedhin një arbitruer të tretë dhe vendimi me shumicë i të treve bëhet detyrues për palët e treta sipas procedimeve të arbitrazhit.

**Bordero (Borderotë)** – Një formë që jep të dhënat e humbjes ose të primit në lidhje me risqet specifike të identifikuar që i jepet risiguruesit nga i risiguruari.

**Kosto e Risigurimit të Humbjes së Pasurisë** – Një term i përdorur shpesh në rastin e risigurimit të humbjes së gjere të pasurisë për të shprehur humbjen e pastër ose, me specifikisht, raportin e humbjeve të krijuara brenda një shume të caktuar që kalon retencionin e kompanisë ceduese ndaj primeve të saj bruto gjatë një numri të parashikuar vitesh.

**Anulimi** - (a) Parimi i vazhdimit nënkupton, në këtë rast, se detyrimi i risiguruesit në përputhje me policat e sigurimit, të cilat kanë hyrë në fuqi sipas marrëveshjes përpara datës së anulimit të një marrëveshjeje të tillë, do të vazhdojnë deri në datën e skadimit të secilës police sigurimi; (b) Parimi i ndërprerjes nënkupton se detyrimi i risiguruesit në përputhje me policat e sigurimit, të cilat kanë hyrë në fuqi sipas marrëveshjes përpara datës së anulimit të një marrëveshjeje të tillë, do të mbarojnë në funksion të humbjeve që rezultojnë nga aksidentet që ndodhin në datën e shprehur të anulimit dhe pas saj. Zakonisht, risiguruesi do t'i kthejë kompanisë portofolin e primit të pafituar, në rast se marrëveshja nuk është shkruar duke u bazuar në parimin e primit të fituar.

**Kapaciteti** – Përqindja e *tepricës* ose e shumës së *ekspozimit* që një *risigurues* dëshiron të vere në risk. Kapaciteti mund të aplikohet ndaj një risku të vetëm, ndaj një programi, ndaj një linje biznesi, ose ndaj të gjithë librit të produkteve.

**Risigurimi nga Katastrofa** - Një formë risigurimi që dëmshpërblen kompaninë ceduese për akumulimin e humbjeve që tejkalojnë një shume të parashikuar që ndodh si pasojë e një ndodhie katastrofike siç është një zjarr i madh, termet apo një stuhi. Humbja nga katastrofa përgjithësisht i referohet totalit të humbjes së një kompanie sigurimi që ndodh si pasojë e një ndodhie të vetme katastrofike.

**Cedim** – kur një kompani risiguron detyrimin e saj në një tjetër kompani, kjo do të thotë se ajo po “cedon” produkt/biznes.

**Komision Cedimi** - *Kosto posedimi të ceduesit* dhe shpenzime operative, taksa, liçensa dhe tarifa, plus një tarifë që përfaqëson një pjesë të fitimeve të pritshme – shpesh e shprehur si përqindje e primit bruto të risigurimit.

**Kompani Ceduese** – Siguruesi primar ose origjinal, kompania e sigurimit e cila blen risigurimin.

**Parimi i Kërkesave të Bëra** - Një formë risigurimi sipas të cilit data e raportimit të kërkesës kërkohet të jete data e *ndodhjes së humbjes*. Prandaj, kërkesat e siguracionit të raportuara gjatë periudhës së marrëveshjes së risigurimit mbulohen, pavarësisht kohës së kur kanë ndodhur. Një marrëveshje e mbështetur në parimin e kërkesave të bëra është konsideruar si “ndërprerje afati”

mbi detyrimin duke mos mbuluar kërkesat e raportuara pas afatit të marrëveshjes së risigurimit – në rast se nuk ka shtyrje afati me anë të ndonjë marrëveshje të veçantë. Shih *Parimin e Ndodhjes*.

**Komision** – Tek risigurimi, kompania primare e sigurimit zakonisht i paguan risiguresit pjesë të saj të primit bruto që merr mbi një risk. Pastaj risiguresi i lejon kompanisë një kompensim të drejtpërdrejtë ose cedues mbi një prim të tillë bruto të marrë, i cili është në shumën e mjaftueshme për të rimbursuar kompaninë për komisionin që kompania u ka paguar agjenteve të saj, plus taksat dhe shpenzimet e saj të natyrës operative. Shuma e një kompensimi të tillë zakonisht përcakton fitimin ose humbjen për risiguresin.

**Klauzola e Shlyerjes** – Një klauzole në një marrëveshje risigurimi, e cila bën vlerësimin, pagesës dhe shlyerjen e plote të gjithë obligimeve të ardhshme për humbjet e shkaktuara të risigurimit, pavarësisht natyrës vazhduese të disa humbjeve të caktuara siç janë përfitimet e pakufizuara mjekësore dhe të tere jetës për Kompensimin e Punëtorëve.

**Komisioni i Kushtit (ose Komisioni i Fitimit)** – Një pagesë në formën e kompensimit që i behet kompanisë ceduese përveç pagimit të komisionit të cedimit normal. Ky është në formën e një përqindje të paracaktuar e fitimit neto të risiguresit pas një pagesë për shpenzimet e natyrës operative të risiguresit, që rrjedh nga marrëveshja subjekt.

**Eksesi Kontribuues** – Kur ka me shumë se një risigures që bashkëndajnë një linjë të risigurimit mbi një risk që tejkalon një retencion të specifikuar, secili sigures i tillë do të kontribuojë në drejtim të çdo humbje të tepërt në proporcion me pjesëmarrjen e tij origjinale në një risk të tillë. Shembull: Retencioni është \$100,000, Risiguresi A pranon gjysmë e pjesës kontribuuese të \$1,000,000 në eksese të shumës së shprehur \$100,000. Risiguresi B pranon pjesën e kontributit të gjysmës së mbetur të shumës \$1,000,000.

**Primi i Fituar** - (1) Është ajo pjesë e primit që përdoret ndaj pjesës së skaduar të afatit të policës, duke përfshirë primin me norme të shkurtër të anulimit, të gjithë primin e shumës së humbjes së paguar sipas disa kontratave, dhe të gjithë primin në kontratën për skadimin e policës. (2) Është ajo pjesë e primit të risiguracionit e llogaritur në baze mujore, tre mujore dhe vjetore, e cila do të ruhet nga risiguresi nëse do të anulohet ndërprerja. (3) Kur primi paguhet në avance për një periudhë të caktuar kohore, kompania thuhet se “e fiton” primin me avancimin e kohës. Për shembull, një police e shkruar për tre vjet dhe e paguar në avance do të konsiderohej e fituar një e treta në fund të vitit të pare.

**Klauzola e Gabimeve dhe e Mosveprimeve** - Është një dispozitë e marrëveshjeve të risigurimit që ka për qëllim të neutralizojë çdo ndryshim të detyrimeve apo të përfitimeve si rezultat i një gabimi të paqëllimtë nga cilado prej palëve.

**Eksesi i Humbjes** - Një formë risigurimi sipas së cilës rigjenerimet janë të disponueshme atëherë kur një humbje e caktuar kalon *retencionin e ceduesit* që është i përcaktuar në marrëveshje.

**Pagesa Ex Gratia** – Është një pagesë e bere për të cilën kompania nuk ka përgjegjësi sipas kushteve të policës saj, e cila zakonisht behet në vend të krijimit të shpenzimeve me të mëdha ligjore kur është fjala për përcaktimin e një kërkesë siguracioni. Ajo haset rralle tek risigurimi meqenëse risiguresi sipas zakonisht dhe për arsye praktike ndjek fatin e kompanisë ceduese.

**Raporti i Shpenzimeve** - Përqindja e primit që përdoret për të paguar të gjitha kostot e posedimit, të regjistrimit dhe të shërbimit të sigurimit dhe të risigurimit.

**Eksperiencia** - (1) Te dhënat e humbjes se një te siguruari ose te një klase mbulimi. (2) Statistika te klasifikuara ndodhish te lidhura me sigurimin , te shpenzimeve ose te ardhurave, faktike ose te vlerësuar. (3) Çfarë tregojnë shifrat se ka ndodhur ne te kaluarën.

Eksperiencia mund te formulohet mbi baza te ndryshme për te siguruar mënyra te ndryshme vlerësimi domethënë te Vitit te Aksidentit, Vitit Kalendarik, ose Vitit te Polices, por, për qëllime nënshkrimi duhet krahasuar gjithnjë primi i fituar me humbjet e shkaktuara pasi këto te fundit te jene modifikuar me ane te një kompensimi për krijimin humbjes dhe për humbjet e shkaktuara porte paraportuara (I.B.N.R.).

**Detyrimet Jashtë-Kontraktore (ECO)** – Një term i përgjithshëm i cili, kur përdoret ne marrëveshjet e risigurimit, i referohet dëmeve te caktuara nga një gjykate kundër një siguruari, dëme te cilat janë jashtë shumave te parashikuara si rezerve (provizioneve) te polices se sigurimit si pasoje e keqbesimit te siguruarit, mashtrimit, apo neglizhencës totale ne trajtimin e një kërkesë. Shembujt janë *demet ndëshkuese* dhe *humbjet ne eksese te limiteve te polices* .

**Fakultative** – Risigurimi fakultativ nënkupton risigurimin e risqeve individuale me ane te ofertës dhe pranimit ku risiguruari ruan “zotësinë” për te pranuar apo për te refuzuar çdo risk te ofruar.

**Risigurimi Financiar** – Një forme risigurimi qe konsideron vlerën kohore te parasë dhe ka depozita te kufizimit te humbjes. Një nder objektivat e saj është te rrisë pasqyrat financiare te *ceduesit* ose te raporteve operative, për shembull, *raporti i kombinuar, transfertat e portofolit te humbjes, dhe pjesët e kuotave financiare*.

**Norma e sheshte** - Tek risigurimi, është norma e përqindjes e aplikuar ndaj shkrimeve te primit te kompanisë ceduese për klasat e produkteve te risiguruara për te përcaktuar primet e risigurimit qe do te paguhen nga risiguruari.

**Ndjekja e Fateve** - Klauzola, e cila parashikon se ne momentin qe një risk është ceduar nga i risiguruari, risiguruari nënshtrohet te njëjtit fat ne vazhdim ashtu siç përjetuar nga kompania ceduese.

**Raporti i Humbjeve te Shkaktuara** – Përqindja e humbjeve te shkaktuara ndaj primeve te fituara. (Shih Eksperiencën.)

**Faktori Inflacion** – Një ngarkese për te mbuluar kostot e rritura mjekësore dhe pagesat e humbjeve ne t e ardhmen si rrjedhoje inflacionit.

**Ndërmjetësues** - Një pale e trete ne hartimin, negociimin dhe administrimin e marrëveshjes se risigurimit. Ndërmjetësuesit u rekomandojnë *ceduesve* llojin dhe shumën se risigurimit qe do te blihet dhe negociojnë rregullimin e mbulimit me *risiguruarit*.

**Klauzole Ndërmjetësimi** - Një dispozite ne marrëveshjet e risigurimit e cila identifikon *ndërmjetësuesin* qe negocion marrëveshjen. Shumica e klauzolave te ndërmjetësimit e kalojnë te gjithë kreditin e riskut tek *risiguruarit* duke siguruar për sa me poshtë vijon:

1. pagesat e *ceduesit* për *ndërmjetësuesin* janë pagesa te kërkuara ndaj *risiguruarit* dhe
2. pagesat e *risiguruarit* ndaj *ndërmjetësuesit* nuk janë pagesa ndaj *ceduesit* derisa merren faktikisht nga *ceduesi*.

Kjo klauzole është e detyrueshme ne disa shtete.

**Shtresëzim** – Një segment horizontal i detyrimit të siguruar, për shembull, shumë a dyte prej \$100,000 në një detyrim prej \$500,000 është shtresëzimi i parë nëse *ceduesi* ruan shumën prej \$100,000, por mund të jete edhe një shtresëzim më i lartë nëse ai ruan një shumë me ulët.

**Krye-Risiguruesi** – *Risiguruesi* i cili negocion termat, kushtet dhe *normat* e primit dhe që firmos i pari në *mandate*; *risiguruesit* të cilët firmosin më pas në *mandate* sipas këtyre termave dhe kushteve konsiderohen *risigurues* pasues.

**Letër Garancie** – Një garanci financiare e lëshuar nga një bankë që lejon palën, të cilës i lëshohet, të tërheqë fonde nga banka në rast të një kërkesë të ligjshme të papaguar kundër palës tjetër; tek risigurimi përdoret në mënyrë tipike për të lejuar marrjen e garancisë së rezervës në funksion të *risigurimit të panjohur*, dhe është alternative ndaj *fondeve të mbajtura* dhe *bashkësigurimit të modifikuar*.

**Shpenzime të Axhustimit të Humbjes** – Të gjitha shpenzimet e një siguruesi që i përkasin axhustimit të tij, regjistrimit dhe të zgjidhjes së kërkesave në ndryshim nga vete pagimi i kërkesave. Termi përfshin shpenzimet e alokuara të axhustimit të humbjes (ALAE), të cilat janë shpenzime të axhustimit të humbjes të identifikuara nëpërmjet një dosje të një kërkesë në regjistrat e siguruesit, të tilla si tarifat e avokateve; dhe shpenzimet e paalokuara të axhustimit të humbjes (ULAE), të cilat janë shpenzime operative të paidentifikuara nga një dosje kërkesë, por që i përkasin në mënyrë funksionale zgjidhjes së humbjeve të tilla si pagat e departamentit të humbjeve.

**Zhvillimi i Humbjes** - Diferenca ndërmjet humbjes origjinale e raportuar në mënyrë origjinale tek risiguruesi dhe vlerësimi pasues i saj në një datë të mëvonshme ose në momentin e zgjidhës përfundimtare të saj. Një problem serioz për risiguruesit të cilët, duke qenë të përfshirë në raste me serioze, është se duhet të presin shpeshherë për shumë vite për zgjidhjen përfundimtare të një humbje.

**Ndodhi Humbje** - Humbjet në total ndaj kompanisë ceduese apo ndaj risiguruesit që rezultojnë nga shkaqe unike siç është stuhia.

**Raport Humbje** - Raporti proporcional i humbjeve të shkaktuara ndaj primeve të fituara i shprehur si një përqindje.

**Risigurim i Panjohur** - Një kompani është “e panjohur” kur ajo nuk është licencuar dhe, për rrjedhojë, nuk është njohur nga autoriteti i duhur qeveritar i sigurimit i shtetit apo i vendit. Risigurimi është “i panjohur” kur ai behet në një kompani të panjohur dhe, për rrjedhojë, mund të mos trajtohet si një aset kundrejt humbjeve të risiguruara apo rezervave të primit të pafituar për kontabilitetin e kompanisë së sigurimit dhe për qëllime pasqyrash.

**Ndodhi** – Një aksident i pafavorshëm i mundshëm ose një ngjarje as e pritur dhe as e synuar nga pikëpamja e të siguruarit. Lidhur me limitet ndaj ndodhive, marrëveshjet e risigurimit të pasurisë nga *katastrofa* shpeshherë përcaktojnë ndodhitë e pafavorshme si ndodhi që kanë një shkak të përbashkët dhe shpeshherë brenda një kuadri kohor të specifikuar, për shembull, 72 ore që mund të jete një afat i në ndodhie. Ky përkufizim ndalon *retencionet* shumëfishe dhe limitet e risigurimit nga ekspozimi në një humbje të vetme në rast *katastrofe*.

**Klauzola e kundërbalancimit** - Një dispozitë në marrëveshjet e risigurimit e cila lejon çdo palë të marrë shumën e maturuara përkundërit atyre që janë të pagueshme përpara se të behet pagesa; e rëndësishme, në mënyrë të veçantë, në rastin e paaftësisë paguese të një pale e cila ndërpret dërgimin e pagesave të maturuara për tek pala tjetër.

**Pjesëmarrja ose Risigurimi ne Baze Proporcionale** - Përfshin Pjesën e Kuotës, Tepricën e Pare, Tepricën e Dytë dhe të gjitha format e tjera të bashkëndarjes së risigurimit ku risiguresi merr pjesë proporcionalisht në të gjitha humbjet dhe në të gjitha primet.

**Rrezik** - Ky term i referohet shkaqeve të humbjeve të mundshme në fushën e pronësisë – për shembull: Zjarri, Stuhia, Përplasja, Breshëri, etj. Në fushën e aksidenteve, përdoret me shpesh termi “Rrezik jetë”.

**Risigurimi i Eksesit Sipas Riskut** – Retencioni dhe shumica a risigurimit aplikohen në baze të parimit “sipas riskut” me shumë se sa sipas aksidentit apo sipas ndodhisë ose në baze të totalit të mbledhur.

**Viti i Policës** - Viti që fillon me datën e hyrjes në fuqi të policës ose me përvjetorin e asaj date.

**Fondi i Bashkuar** - Një organizim i siguresve ose risiguresve nëpërmjet të cilit sigurohen lloje të veçanta të riskut me anë të primeve, të humbjeve dhe shpenzimeve të bashkëndarë në raporte të pranuar.

**Risigurimi i Portofolit** - Në transaksionet e risigurimit i referohet të gjitha risqeve të lidhura me transaksionin e risigurimit. Për shembull, nëse një kompani risiguron të gjithë produktin e papaguar të automjeteve të një tjetri, kompania risiguresve thuhet se zotëron “portofolin e produktit të automjeteve dhe i paguhet totali i primit të pafituar mbi të gjitha risqet e risiguruara (pa një pjesë të pranuar komisioni).

**Portofoli vazhdues** - E kundërta e Fitimit të Portofolit – lejon primet dhe humbjet që përkasin biznesit në fuqi të vazhdojnë deri në afatin normal të skadimit me përfundimin e marrëveshjes së risigurimit.

**Depozite Primi** - Kur termat e një police sigurojnë që primi final i fituar të përcaktohet në një kohë pasi të jete vetë shkruar polica, atëherë kompanitë mund të kërkojnë në fillim prime të karakterit tentues ose “depozite”, të cilat riaktivohen kur çmimi i fituar faktik është përcaktuar me vone.

**Primi, i Pastër** - Pjesa e primit e llogaritur që të mundësojë siguresin të paguajë humbjet dhe, në disa raste, shpenzimet e alokuara të kërkesave ose primin e arritur duke ndarë humbjet sipas ekspozimit dhe mbi të cilin nuk është shtuar ndonjë barre për komision, taksa, dhe shpenzime.

**Primi (I Shkruar/I Pafituar/I Fituar)** – Primi shkruar është një prim i regjistruar në librat e një siguresi ose të një risiguresi në momentin që është lëshuar dhe paguar një police. Primi për periudhën e ardhshme të ekspozimit quhet prim i pafituar për një police individuale, prim i shkruar minus primin e pafituar është i barabartë me primin e fituar. Primi i fituar është e ardhur për periudhën kontabël, ndërsa primi pafituar do të jete e ardhur në periudhën e ardhshme kontabël.

**Risiguresi Profesional** - Një term i përdorur për të përshkruar një kompani biznesi i se cilës është i kufizuar vetëm tek risigurimi dhe shërbimet anësore të ofruara nga një risigures për klientët e tij në ndryshim nga siguresit primare të cilët këmbëjnë risigurim ose operojnë departamente risigurimi si ndihmës të biznesit të tyre baze të sigurimit primar. Shumica e risiguresve profesionale japin risigurim të plote dhe shërbim në një burim drejtpërsëdrejti për kompaninë ceduese.

**Komisioni Fitimi** - Një dispozitë që gjendet në disa marrëveshje risigurimi që mbulon bashkëndarjen e fitimit. Palët bien dakord për një formulë për llogaritjen e fitimit, për një

kompensim të shpenzimeve të *risiguruesit*, dhe për pjesën e ceduesit të një fitimi të tillë pas shpenzimeve.

**Pjesa e Kuotës** - Forma baze e marrëveshjes me pjesëmarrje ku risiguruesi pranon një përqindje të shprehur të secilit dhe çdo risku brenda një kategorie të përcaktuar biznesi në baze proporcionale. Pjesëmarrja në çdo risk është e fiksuar dhe e sigurte.

**Klauzola e Rigjenerimit** – Kur një shumë e mbulimit të risigurimit e dhënë sipas një marrëveshje zvogëlohet nga pagesa e humbjes së risigurimit si rezultat i një katastrofe, mbulimi risigurimit zakonisht rigjenerohet automatikisht me anë të një pagese të primit të rigjenerimit.

**Primi i Rigjenerimit** – Një prim proporcional risigurimi vendoset për rigjenerimin e shumës së mbulimit të risigurimit që u ul si rezultat i pagesës së risigurimit të humbjes në përputhje me mbulimin e një katastrofe.

**Risigurim** – Praktika në të cilën një pale e quajtur Risiguruesi e cila, në përputhje me primin e paguar ndaj tij, pranon të zhdëmtojë një pale tjetër të quajtur i risiguruari, për një pjesë ose për të gjithë detyrimin e prezumuar nga pala e dytë sipas një police ose policave të sigurimit që ajo ka lëshuar. I risiguruari mund të quhet edhe Siguruesi Primar ose Origjinal, ose Kompania e Drejtpërdrejtë Regjistruese, ose Kompania Ceduese.

**Risigurues** – Një sigurues ose risigurues që merr riskun e një tjetri me kontratë.

**Retencion** – Shuma neto e riskut, të cilin kompania ceduese ose risiguruesi e mban për llogari të vet ose ajo e të tjerëve që janë të specifikuar.

**Retroçesion** – Risigurimi i risigurimit. Shembull: Kompania "B" ka pranuar risigurim nga Kompania "A", dhe pastaj merr për veten e saj, në një biznes të tillë të prezumuar, risigurim nga Kompania "C". Ky risigurim sekondar quhet Retroçesion. Transaksioni ku një risigurues cedon tek një risigurues tjetër të gjithën ose një pjesë të risigurimit që ai kishte marrë me përpara.

**Vlerësimi Retrospektiv** – Një plan ose metode e cila lejon axhustimin e primit ose të komisionit cedues final të risigurimit në baze të eksperiencës së humbjes faktike sipas marrëveshjes subjekti të risigurimit – që i vështrohet limiteve minimale dhe maksimale.

**Risqe** – Një term i përdorur për të treguar njësitë fizike të pronës në rrezik ose objekt i mbrojtjes së sigurimit dhe jo rreziqet ndaj pasurisë apo ndaj jetës. Risigurimi, sipas traditës, lejon çdo kompani sigurimi të krijojë kuadrin e vetë të rregullave për përkufizimin e njësive të risqeve. Fjala është përkufizuar edhe si shans i humbjes ose pasiguria e humbjes.

**Shpëtimi dhe Zëvendësimi** - Këto të drejta të të siguarit, të cilat, në përputhje me termat e police, transferohen në mënyrë automatike tek siguruesi me zgjidhjen një humbje. Shpëtimi aplikohet ndaj çdo të ardhure nga pronat e riparuar, të rigjeneruara ose të shkatërruara. Zëvendësimi i referohet të ardhurave nga negociimet ose nga veprimet ligjore kundër palëve të treta neglizhuese dhe mund të aplikohet ndaj mbulimit të rasteve të pronësisë dhe të rasteve të vdekjeve.

**Vete-sigurimi** - Vënia mënjane e fondeve nga një individ ose organizatë për të plotësuar humbjet e tij ose të saj, dhe për të absorbuar luhatjet në shumën e humbjes, ku humbja rëndohet ndaj fondeve të kursyera ose të akumuluar.



**Komisioni i Shkalles Rënëse** – *Një komision cedimi*, i cili ndryshon në mënyrë inverse me raportin e humbjes sipas marrëveshjes së risigurimit. Shkallët nuk janë gjithnjë një me një: për shembull, kur *raporti i humbjes* ulet me 1%, *komisioni cedues* mund të rritet vetëm me 5%.

**Pakete Abonimi** - Një *dosje* që përmban me shume se sa një *riregjistrues*. Në Lloyd's të Londrës paketa kalohet nga një nënshkruar tek një tjetër për pranuar dhe për t'u abonuar në një pjesë specifike të riskut.

**Pranim i Veçante** – Zgjatje fakultative e paktit të risigurimit për të përfshirë një risk që nuk është i përfshirë automatikisht brenda termave.

**Humbje e Shpërndarë** - Një formë risigurimi net e cilën primet paguhen gjatë viteve të mira për krijim të një fondi i cili shërben për mbulimin e humbjeve në vite të këqija. Ky risigurim ka efektin e stabilizimit të raportit të humbjes së ceduesit gjatë një pridhe të zgjatur kohe.

**Humbja e Ndalimit** - Një formë risigurimi në të cilën *risiguresi* paguan një pjesë ose të gjitha humbjet e ruajtura të mbledhura në total të *ceduesit* në eksese të shume të parapërcaktuara ose në eksese të një përqindje të primit.

**Primi Subjekt** – Primit e një *ceduesi* (të shkruar ose të fituar) ndaj të cilëve aplikohet *norma* e primit të risigurimit për të llogaritur primin e risigurimit. Shpesh, primi subjekt është e ardhur neto/bruto e primit të shkruar (GNWPI) ose e ardhur neto/bruto e primit të fituar (GNEPI), ku termi “bruto” do të thotë bruto përpara zbritjes së primeve të risigurimit për marrëveshjen e risigurimit në shqyrtim; dhe “neto” pas të gjitha axhustimeve të tjera, p.sh., anulimit, refinacimit, apo risigurime të tjera. Normalisht, *primi subjekt* i referohet primit në biznesin subjekt. Ky njihet edhe si primi baze.

**Teprice** - Eksesi i aseteve mbi detyrimet. Teprica statusore është një kapital siguruesi ose *risiguresi* siç përcaktohet në rregullat statusore të kontabilitetit. Teprica përcakton *kapacitetin* e një siguruesi ose të një *risiguresi* për të regjistruar biznes.

**Pjesa e Tepricës** - Një formë e risigurimit proporcional ku risiguresi merr përgjegjësinë proporcionale vetëm për atë pjesë të riskut i cili kalon retencionet e krijuara të kompanisë.

**Marrëveshje e Llojit Pakt** - Një marrëveshje e përgjithshme risigurimi që është e detyrueshme ndërmjet kompanisë ceduese dhe risiguresit që përmban termat kontraktual që aplikohen ndaj risigurimit të një klase ose të disa klasave të biznesit, në kontrast me marrëveshjen e risigurimit që mbulon një risk individual.

**Humbja Neto Përfundimtare** - Ky term zakonisht nënkupton shumën totale të cilën i siguruari ose çdo kompani në kapacitetin e siguresit të tij, ose të dyja, detyrohen të paguajnë ose nëpërmjet gjykatës ose nëpërmjet kompromisit, dhe zakonisht përfshin spitalin, detyrimet shëndetësore dhe funerale dhe të gjitha shumat e paguara si paga, kompensime, tarifa, pagesa dhe kosto gjyqësore, interesat, shpenzimet për mjeket, juristet, infermieret, hetuesit dhe persona të tjerë, për zgjidhjen e çështjeve gjyqësore, zgjidhjen, axhustimin dhe investigimin e kërkesave dhe të padive të cilat paguhen se pasoje e humbjes së siguar, duke përjashtuar vetëm pagat e të siguarve apo të të punësuarve të përhershëm që varen tek siguresit.

**Primi i Pafituar** – Ajo pjesë e primit origjinal që aplikohet ndaj pjesë së paskaduar të riskut. Një sigurues ose risigurues zjarri ose aksidentesh duhet të mbajë një rezervë kundrejt të gjithë primeve të pafituar si detyrim në pasqyrat e tij financiare, sepse në rast se policat duhet të anulohet, atëherë kompanisë do t'i duhet të kthejë pjesën e pafituar të primit origjinal.

**Shtresëzimi Funksionues** – Niveli e parë mbi *retencionin e ceduesit* ku pritet një aktivitet humbje nga i moderuar deri tek i rëndë nga ana e *ceduesit dhe e risiguruesit*. Marrëveshjet e risigurimit të shtresëzimit funksionues shpesh përfshijnë *karakteristika të axhustueshme* për të reflektuar rezultat faktike të nënshkrimeve.

Burimi: [www.captive.com](http://www.captive.com)